

PANAIRI NDËRKOMBËTAR

EXPOKOS



18-19.05.2023

Edicioni i 22-të
Prishtinë, Kosovë

energji
ndërtim
makineri
mbrojtje
dhe siguri



ufi
Approved
Event



Nën Patronatin e
Qeverisë së
Republikës së Kosovës

Porta e Ballkanit!



PANAIRI NDËRKOMBËTAR - EXPOKOS

Edicioni i 22-të | 18 - 19 Maj 2023

Prishtinë, Kosovë

Panairi EXPOKOS, është ngjarja më e rëndësishme biznesore në regjionin e Ballkanit perëndimor.

Edicioni i 21-të i EXPOKOS, është mbajtur nën patronatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjatë këtij edicioni, është konfirmuar se edicionet e ardhshme do të organizohen në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Edicioni i 22-të i EXPOKOS, do të vazhdojë të mbulojë sektorët e Ndërtimit, Energjisë, Minierave, Makinerisë dhe Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Tash e 22 vite, EXPOKOS njihet si panair shumë efikas, në aspektin e mundësive që ka ofruar për bizneset që të zgjerohen në tregje të reja dhe në gjetjen e partnerëve dhe klientëve serioz. Për më tepër, EXPOKOS është një ngjarje ku pavijone kombëtare nga shtete të ndryshme, vizitorë të zgjedhur profesional dhe vendimmarrësit takohen së bashku.

E shoqëruar me konferenca dhe prezantime të fokusuara në kompanitë e Ballkanit perëndimor, aktivitete të ndryshme paralele si ligjërata nga profesionistët dhe panele diskutimi, EXPOKOS tërheqë vëmendje dhe prezencë të madhe të vizitorëve.

PSE TË EKSPOZONI NË EXPOKOS?

Komunikim dhe ndërveprim interaktiv ndërmjet ekspozuesëve dhe vizitorëve profesional

Qasje në tregun regjional me rritje të shpejtë dhe potencial të madh

Takime direkte me prodhues dhe distributorë të njohur

Prezenca e vendimmarrësve

Rrjetëzim efektiv

KUSH DO TË PARTICIPOJË NË EXPOKOS 2023?

Pavijone kombëtare nga Ballkani dhe Evropa

Kompani të njohura botërore

Institucione akademike relevante me konceptin e panairit

Vizitorë profesional nga Kosova dhe regjioni i saj, Evropa dhe Azia.

AKTIVITETET PARALELE GJATË PANAIRIT EXPOKOS:

Konferenca për shtyp

Takime B2C, B2B dhe B2G

Takime ndërlidhëse

Evente profesionale dhe informative biznesore: seminare, workshope, ligjërata dhe prezantime nga profesionistët të përfshirë në fushat e ndërtimit, energjisë dhe patundshmërisë

Praktikat më të mira të të bërit biznes në Ballkan.

INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT PËRKRAHËSE:

Qeveria e Republikës së Kosovës

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministria e Ekonomisë

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Fakulteti i Arkitekturës – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Oda të ndryshme Ekonomike regjionale dhe ndërkombëtare

PLATFORMA B2B

Nëpërmjet shërbimit tonë 365 ditë Business-to-Business, ne ofrojmë përkrahje për ekspozuesit tonë në mënyrën më efikase të mundshme duke ju ndihmuar të gjejnë partnerë serioz afarist në Kosovë dhe në shtetet e saj fqinje.

Të gjitha kompanitë të cilat regjistrohen si ekspozues brenda afatit për edicionin e 22-të të panairit EXPOKOS, që do të mbahet me 18-19 Maj 2023 në Prishtinë, do të përfitojnë nga shërbimi jonë B2B në baza ditore, pa pagesë për një periudhë një vjeçare.

Kompanitë të cilat rezervojnë stendën **sot**, do të përfitojnë nga shërbimi jonë B2B, e cila do të ju shërbejë në gjetjen e partnerëve ideal **nesër**.



SEKTORËT E PANAIRIT

EXPOKOS 2023,
do të përfshijë katër sektorë.

NDËRTIM

Materiale ndërtimore; Sisteme dhe pajisje ndërtimi; Lënda e parë; Produkte ndërtimore kimike të parafabrikuara; Izolim; Ngrohje dhe teknologji sanitare; Instalime elektrike; Kallëpe për betonim dhe Skele; Qeramikë; Dyer dhe Dritare; Përpunim të metaleve; Dekorime të shtëpive dhe ndërtesave; Ndërtimi i rrugëve; Fasada xhami; Materiale ndërtimi nga xhami; Ndërtim i kulmeve; Ndriçim rrugor dhe të parqeve; Ashensorë; Interier; Gurë natyral; çelik; Riciklim dhe shumë tjera.

ENERGJI & MINIERA

Industria e energjisë elektrike; Energjia alternative: Energjia solare, hidroenergjia, energjia gjeotermale dhe e biomasës; Ministri dhe institucione tjera relevante; Prodhues, furnitorë, distributorë dhe ofrues të shërbimeve dhe produkteve (ST) solare termike; Prodhues, furnitorë, distributorë dhe ofrues të shërbimeve dhe produkteve (PV) fotovoltaike; Sisteme dhe integrues PV dhe ST; Miniera dhe minerale; Shkrirje e metaleve; Makineri për përpunim të mineraleve; Makineri për hapjen e minierave; Makineri për shpim; Makineri për transportim të mineraleve; Vegla pune, mbathje dhe pajisje për siguri në punë dhe shumë të tjera.

MAKINERI

Pajisje të kontrollit të kualitetit; Instrumente dhe makineri për matje; Pajisje analitike; Pajisje automatike dhe robotike; Makineri ndërtimi dhe pajisjet shtesë; Makineri për bartje dhe pajisje shtesë; Makineri speciale për ndërtim, mirëmbajtje dhe riparim të rrugëve; Pajisje shpimi; Makineri për hapje të tuneleve; Pajisje metalike dhe jo metalike; Pajisje hidraulike; Makineri Industriale; Metalurgji; Shkritore; Industria e plastikës dhe kimike; Automjete ndërtimi; Makineri ndërtimi dhe pajisje shtesë dhe shumë të tjera.

SIGURI & MBROJTJE

Sisteme të kontrollit të aksesit; Teknologji biometrike; Sisteme të menaxhimit të ndërtesave; Certifikime dhe Kontroll i kualitetit; Siguri rezidenciale dhe komerciale; Sisteme digjitale të monitorimit; Siguri e dokumenteve; Alarm emergjent dhe sisteme paralajmërimi; Siguri për hardware; Sisteme dhe pajisje identifikimi; Siguri informacioni dhe rrjeti; Lente dhe Ekrane LCD; Sisteme të monitorimit të rrjetit; Trajnime për siguri dhe shëndet; Siguria dhe mbrojtja në punë; Veshje pune dhe shumë të tjera.



PËRSHTYPJET

Z. Besnik Bislimi

Zv. Kryeministër i Republikës së Kosovës

“Për mua është kënaqësi e veçantë të bëj hapjen e edicionit të 21-të të EXPOKOS, e cila është ngjarja më e rëndësishme jo vetëm në Kosovë por edhe në të gjithë Ballkanin perëndimor. Me këtë ngjarje, është arritur që Kosova të vendoset në hartat ndërkombëtare të ngjarjeve biznesore”.

Znj. Artane Rizvanolli

Ministre e Ekonomisë:

“Është kënaqësi për mua të jem këtu sot, të shoh për së afërmi zhvillimet, sfidat dhe sukseset e tregut. Sot do të takoj kompanitë personalisht në mënyrë që të kuptoj më mirë aktivitetet e tyre dhe ti informoj për aktivitetet e qeverisë, gjë që mund të ndihmojnë bizneset gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre”.

Znj. Rozeta Hajdari

Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:

“Jam shumë e lumtur të jem këtu sot së bashku me kolegët e mi, sepse është shumë me rëndësi që Kosova është nikoqire e një ngjarjeje ku shtete të huaja marrin pjesë”.

Z. Mariano Anthony Davies

Kryetar, Oda Ekonomike e Britanisë në Kosovë:

“Ne kemi përcjellur këtë ngjarje për disa vite tani, është kënaqësi e madhe që Oda Ekonomike e Britanisë të jetë këtu. Ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë në rritjen e bizneseve dhe të përdorim Kosovën si qendër të biznesit për rajon”.

Z. Marco Locati

Beck & Heun – Germany

“Kemi pasur eksperiencë shumë të mirë për këto dy ditë të EXPOKOS, kemi takuar shumë kompani si prodhues të dritareve, dizajnerë, inxhinier dhe kompani ndërtuese, të interesuara për bashkëpunim me kompaninë tonë. Pas panairit, do të kemi një takim me një nga kompanitë ku pritet të firmosim marrëveshje bashkëpunimi.”

Z. Alessandro Zanin

NCB International – Italy

“Kemi vendosur që të marrim pjesë në EXPOKOS që të plasojmë produktet tona në tregun e Kosovës duke gjetur partnerë në Kosovë. Kemi pasur shumë kontakte të mira deri më tani. Përpos shitjes, këtu kemi gjetur edhe furnitorë për nevojat tona.”

Znj. Gladina Geshi

Lhyra Balkan – Italy

“Qëllimi i kompanisë tonë është që përmes EXPOKOS, të zgjerohemi në Evropë dhe Ballkan sa më shumë përmes kontakteve të krijuara në këtë panair.”

Z. Drilon Brahim

MONTING

“Kemi vendosur të marrim pjesë në panair me qëllimin e gjetjes së tregjeve të reja si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj. Duke pasur parasysh vizitat në panair nga klientë vendor dhe ndërkombëtar, pritshmëritë tona janë të mëdha. Kemi krijuar shumë kontakte me vizitorë të huaj dhe vendor për të cilët do të ofrojmë shërbimet dhe produktet tona në të ardhmen.”

Znj. Arta Januzi Cana

Fakulteti i Arkitekturës – Universiteti i Prishtinës:

“EXPOKOS është një mundësi shumë e mirë që të prezantohemi si fakultet dhe të krijojmë kontakte me kompani në fushën e teknologjisë së ndërtimit dhe arkitekturës. Po ashtu është një pikë takimi ndërmjet studentëve tonë dhe punës që i pret pas përfundimit të studimeve”

Z. Armend Demolli

BRICKOS

“Qëllimi jonë kryesorë është të promovojmë brendin tonë në Kosovë dhe pse jo edhe më gjerë. Një ngjarje si EXPOKOS me një organizim profesional që po vizitohet nga i gjithë rajoni, na ndihmon shumë të arrijmë qëllimet tona”

TEMAT KYÇE

Ligjërata dhe prezantime nga ekspertët nga fusha e ndërtimit, arkitekturës, energjisë dhe pajisjeve teknike.

Sfidat e ndryshimit klimatik.


Strategjia e Kosovës dhe rajonit për energji të ripërtëritshme.


Trendet e mbetjeve dhe riciklimit.

Transformimi digjital i sektorit të ndërtimit.

Siguria dhe mbrojtja në punë dhe jashtë punishtes.

FOTO GALERIA NGA EDICIONET E KALUARA TË PANAIRIT EXPOKOS





EXPOKOS 2022 në numra – Statistika nga Edicioni i 21-të

Informata mbi ekspozuesit	Numri
Numri i ekspozuesëve vendor	145
Numri i ekspozuesëve të huaj	112
Kompani të përfaqësuara	13
Numri total i ekspozuesëve	270

Origjina e ekspozuesëve:

Shqipëri, Austri, Itali, Gjermani, Belgjikë, Holandë, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Mali i Zi, Kroaci, Slloveni, Serbi, Greqi dhe Turqi.

Informata mbi vizitorët:			
VIZITORË VENDOR	Numri	VIZITORË TË HUAJ	Numri
Vizitorë Profesional	13,500	Vizitorë Profesional	2,800
Vizitorë të përgjithshëm	2,300	Vizitorë të përgjithshëm	120
Numri total i vizitorëve vendor	15,800	Numri total i vizitorëve të huaj	2,920
Total Vizitorët (Vendor dhe të huaj): 18,720			

Origjina e vizitorëve:

Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Mal i Zi, Kroaci, Slloveni, Serbi, Greqi, Turqi, Itali, Gjermani, Republika Çeke dhe Hungari.



EXPOKOS

INFORMATA ME RËNDËSI PËR LEHTËSIMIN E PJESËMARRJES TUAJ NË EXPOKOS 2023

Për ta rezervuar pjesëmarrjen tuaj si ekspozues në EXPOKOS 2023, ju lutem na kontaktoni në:




Congress & Event Organization

tel: +383 (0) 38 516 013
mob: +383 44 629 916
e-mail: info@ceokos.com
web: www.ceokos.com/expokos/

Ekipi i CEO do të ju asistojë me kënaqësi që të keni një ekspozim të suksesshëm, produktiv dhe profesional në Panairin Ndërkombëtar EXPOKOS 2023.

#EXPOKOS23

HAPËSIRAT E PANAIRIT



INDEX

Fair Ground Prishtina

Total Exhibition Area = 20.000 m²

Total Indoor Area = 11.000 m²

Total Outdoor Area = 9.000 m²

INDEX

Indoor exhibition halls

Indoor montage exhibition halls

Open exhibition area



EXPOKOS

